



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 107, datë 5.10.2015

MBI

**PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE PËR ANËTAR TË KOMITETIT
KËSHILLIMOR PËR HARTIMIN E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT NË TREGUN E
SIGURIMEVE**

Në zbatim të nenit 15, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" i ndryshuar, dhe në zbatim të Vendimit nr. 33, datë 28.05.2015 "Për ngritjen e komitetit këshillimor për hartimin e politikave në tregun e sigurimeve", pas realizimit të procedurës së konkurrimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e pikës 5, të Vendimit nr. 33, datë 28.5.2015 "Për ngritjen e komitetit këshillimor për hartimin e politikave në tregun e sigurimeve".
2. Përzgjedhjen e z. Genc Çifligu dhe z. Ildir Gjata si anëtar të Bordit Këshillimor për hartimin e politikave të zhvillimit të tregut të sigurimeve.
3. Objekti i punës i Komitetit Këshillimor të Bordit të AMF-së do të jetë draftimi i një dokumenti të zhvillimit strategjik të tregut të sigurimeve nëpërmjet zhvillimit, zgjerimit dhe diversifikimit të tregut të sigurimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare. Dokumenti duhet të përfshijë ndër të tjera instrumentat për rritjen e ndërgjegjësimit e konsumatorit në bashkëpunim me kompanitë e sigurimit, në lidhje me zgjerimin dhe thellimin e tregjeve për produktet e sigurimit.
4. Komiteti Këshillimor do të diskutojë draftin e strategjisë me palët e interesit dhe do të reflektojë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në dokument përpara dorëzimit në Bord.
5. Afati kohor për realizimin e objektivave të Komitetit Këshillimor do të jetë 6 muaj nga data e fillimit të punës së Komitetit Këshillimor.

6. Shpërblimi i anëtarëve të Bordit Këshillimor do të jetë sa 40 % e pagës së këshilltarit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI